

**Akti i Themelimit i  
"Admeks" sh.p.k.**

Në mbështetje të legjislacionit shqiptarë, në ligjin nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", në dokument referuar si "Ligji", hartohet Akti i Themelimit, me kushtet që përçaktohen si më poshtë:

**Neni 1**

Baza ligjore

Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar Admeks, në vijim referuar si "Shoqëria" themelohet sipas formës dhe kuptimit të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", pjesa IV – Shoqëritë me Përgjegjësi të Kufizuar, si dhe në përputhje të plotë me Kodin Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

**Neni 2**

Emërtimi

Shoqëria quhet Admeks. Ky emërtim formohet si rrjedhim dhe kuptim i togfjalëshit "Ekspertët e administrimit".

**Neni 3**

Sigla (Logo)

Forma dhe përmbajtja e siglës (logos) përcaktohet nga organet drejtuese të shoqërisë.

**Neni 4**

Vula

Forma dhe përmbajtja e vulës përcaktohet nga organet drejtuese të shoqërisë. Vula figuron në të gjitha shkresat dhe korrespondencën që del prej shoqërisë. Vula mbahet dhe administrohet nga Drejtori Ekzekutiv.

**Neni 5**

Selia

Selia është në adresën: Rruga "Qemal Stafa", pallati 2, hyrja 3, kati 1, apartamenti 5, Tiranë, Shqipëri. Kjo adresë mund të ndryshojë në varësi të veprimtarisë së shoqërisë.

**Neni 6**

Faqja web

Faqja web është [www.admeks.al](http://www.admeks.al).

**Neni 7**  
Posta elektronike

Posta elektronike që mund të përdoret për qëllime të komunikimit elektronik është info@admeks.al.

**Neni 8**  
Kohëzgjatja

Shoqëria do të veprojë në një afat kohor të pacaktuar. Përfundimi i veprimtarisë bëhet me vendim të Bordit të Aksionerëve.

**Neni 9**  
Qëllimi dhe Fushat e veprimtarisë

Shoqëria aspiron të realizojë aktivitetet e mëposhtme:

1. Administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit.
2. Kuptimin e nevojave të konsumatorëve dhe ofrimin e mundësive teknologjike që i plotësojnë këto nevoja.
3. Planifikimin e përdorimit efektiv dhe strategjik të teknologjive të reja, në shërbim të biznesit dhe shoqërisë.
4. Ofrimin e shërbimeve që plotësojnë kërkesën konsumatore, të tilla si shërbimet sanitare, elektrike, hidraulike, etj. Objekti i këtyre shërbimeve është ndërtimi i njësive, restaurimi i tyre apo mirëmbajtja, duke vepruar nëpërmjet stafit të specializuar të shoqërisë dhe/apo palëve të treta.

**Neni 10**  
Data e themelimit

Shoqëria themelohet më datë 28 qershor 2018.

**Neni 11**  
Themeluesi

Shoqëria krijohet me Aktin e Themelimit, nënshkruar me vullnetin dhe iniciativën e lirë të themelusit të saj të vetëm **Z. Denis Balla**.

**Neni 12**

Kapitali fillestarë

Kapitali themeltar fillestarë i shoqërisë është **100** Lekë, i përbërë nga 1 kuotë e vetme me vlerë 100 Lekë. Kapitali përbëhet 100% nga kontributi i themeluesit të vetëm të shoqërisë.

**Neni 13**

Organet drejtuese

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

1. Bordi i Ortakëve
2. Drejtori Ekzekutiv

Organi i vetëm vendimmarrës i Admeks SH.P.K. është Bordi i Ortakëve.

Drejtor Ekzekutiv emërohet ortaku i vetëm **Z. Denis Balla**, i biri i Zihniut, lindur në Librazhd më 28.05.1993, banues në Tiranë.

**Neni 14**

Përfaqësimi ligjor

Perfaqesues ligjor i Shoqërisë është Drejtori Ekzekutiv. Nëse ai për arsye të ndryshme nuk është i disponueshëm, ia kalon këtë të drejtë një punonjësi tjetër të Shoqërisë me anë të një dokumenti të shkruar, ku përcakton shprehimisht kompetencat që ka deleguar dhe shtrirjen kohore të vlefshmërisë së delegimit.

Ky Akt hartohet në katër kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Tiranë, më 28 qershor 2018.

Themeluesi:

**Denis Balla**

